

# Viti kur Perëndimi humbi drejtimin strategjik



Bodo Weber

2015-a mbase paraqet vitin më intensiv politik në historinë e shkurtër të shtetit të Kosovës, për politikën perëndimore ndaj Kosovës, por edhe për perspektivën e brendshme politike. Viti nisi me përparimin e dialogut Prishtinë-Beograd, që ishte bllokuar për një vit të tërë, dhe me krizën masive të refugjatëve gjatë dimrit 2014/2015. Kosovarët votuan me këmbët e tyre, duke shprehur zhgënjimin dhe dëshpërimin e tyre të thellë ndaj sistemit politik të vendit për shkak se kutitë e tyre të votimit ishin devaluuar prej drejtësisë së varur dhe ndërhyrjes perëndimore në prapaskenë. Kështu, në vend se të kishin shpresë për ndryshim të vërtetë, qytetarët e Kosovës inauguruan atë që më vonë do të bëhej rruga e Ballkanit për krizën evropiane të refugjatëve. Viti përfundoi me një vendim të Brukselit për liberalizimin e vizave, që kosovarëve u krijoi përshtypje të përziera për BE-në dhe shtetin e tyre, dhe me një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, që mund të zhblokojë dialogun, por edhe të hapë kutinë e Pandorës, mirëpo assesit nuk do të zgjidhë krizën e brendshme politike.

Diku në këtë mes është marrëveshja e 25 gushtit për parimet dhe elementet bazike të Asociacionit? Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, që çoi vendin drejt krizës më të thellë politike që nga Shpallja e Pavarësisë, dhe erdhi dështimi i aplikimit për anëtarësim në UNESCO.

Qysh prej përfundimit të luftës më 1999, Perëndimi është munduar të menaxhojë dhe baraspeshojë dy sfida në Kosovë, duke zgjidhur statusin e vendit dhe duke e vënë vendin në shtegun e duhur drejt transformimit demokratik; më 2015, të dy këto aspekte u bënë bashkë, por për keq. Me suksesin fillestar të Marrëveshjes së prillit 2013, që ishte një rrugë e duhur drejt sovranitetit të plotë të Kosovës, Perëndimi tregoi çështjen demokratike që dialogu të ishte prioriteti kryesor. Me përzjerjen e tij në procesin e formimit të koalicionit më 2014, vetëm bëri një zgjidhje të përkohshme, por i kontribuoi thellimit të mëtejshëm të krizës politike në Kosovë më 2015, që e rrezikoi dialogun edhe si tërësi.

Tash që po mbaron viti, Marrëveshja e prillit 2013 hyn në vitin e tretë të vonësës së zbatimit - një arsye e mjaftueshme për një rivlerësim të shpejtë të dialogut. Kur kancelarja gjermane, Angela Merkel, ndryshoi politikën perëndimore ndaj Kosovës pas trazirave të dhunshme në verën e vitit 2011 në veri të Kosovës, drejtimi i ri ishte një zhvillim pozitiv që kon-

**Me qëllim që Perëndimi të ndreqë gabimet në politikën e vet ndaj Kosovës dhe të fitojë përsëri besimin e qytetarëve të vendit më 2016, BE-ja dhe SHBA-ja duhet të pranojnë se qasja e tanishme politike nuk është e qëndrueshme**

siderohej edhe prej perspektivës së BE-së dhe asaj më të gjerë perëndimore - për shumë arsye. Së pari, për shkak se BE-ja kishte nisur më në fund të bëhej aktor serioz, pavarësisht ndasive të brendshme për Pavarësinë e Kosovës. Së dyti, për shkak se BE-ja i dha përkrahje kapitalizimit të ndasisë së bllokut evropian prej anës së Beogradit pse nuk e njihnin Kosovën, duke i treguar kështu Serbisë se me qasjen "BE-ja dhe Kosova" nuk do të mund të llogariste më në përkrahjen e pesë shteteve që nuk e kishin njohur Kosovën. Kështu, Beogradit iu bë e qartë se nuk mund të llogariste në mbështetjen e pesë shteteve që të hynte në klub. Së treti, për shkak se Gjermania, hegjemoni hezitues i BE-së, më në fund mori kryesimin e çështjes së politikës

së jashtme. Dhe së katërti, për shkak se Berlioni i tregoi Beogradit atë që elita politike serbe e dinte qysh prej vitit 2008 - se Kosova përfundimisht ka shkuar dhe se duhet ta harrojnë çfarëdo ideje për ndarje territoriale - dhe e bëri këtë bazë të politikës së dialogut.

Prapëseprapë, qasja dialog - ndihmo Kosovën të shtrijë sovranitetin e plotë me integrim të plotë të minoritetet serb dhe me heqje të institucioneve shtetërore serbe nga toka e Kosovës nëpërmjet anëtarësimit të Serbisë në BE, mbështetur me dialog politik - prej fillimit ishte ngarkuar me shumë sfida që duhej të adresoheshin:

a. Për BE-në, kjo paraqiste një ndërmarje të sofistikuar të pashembullt në historinë e politikës së jashtme dhe përfundimisht të integritit të Bashkimit Evropian, që kërkonte lidhshmëri konsistent gjerman, fuqizuar prej bashkëpunimit britanik dhe përkrahjes amerikane.

b. Çështjet kyç strategjike kanë mbetur hapur qysh prej fillimit, veçanërisht çështja e pikës së përfundimit të dialogut - çfarë do të ishte rezultati përfundimtar i "normalizimit të plotë" të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - njohja e pavarësisë së Kosovës prej Beogradit, apo diçka tjetër? Dhe se si mund të garantohej obligimi i Serbisë i fiksuar në Marrëveshjen e prillit - se nuk do ta bllokojë per-



spektivën evropiane të anëtarësimit të Kosovës në BE? Kjo vë në dyshim çështjen nëse BE-ja/Perëndimi kishin ndonjë masterplan për dialogun.

c. Me qëllim që t'iu bëhet presion serbëve të Kosovës në veri që të ndjekin kursin e ri të integritimit në shtetin e Kosovës, Perëndimi duhej ta lejonte Serbinë të hynte përsëri në thellësi të Kosovës. Kjo kërkonte një strategji se si më vonë të rikthehej procesi në pikën përfundimtare të nxjerrjes së Serbisë prej shtetit të Kosovës.

d. Edhe me politikën integruese dhe strukturat juridike në veri në sistemin e institucioneve të Kosovës, një detyrë kyç mbeti të zgjidhej më vonë - si t'i jepej fund ambientit pa sundim ligji në veri, në të cilin policët, gjykatësit dhe prokurorët serbë për një dekadë e gjysmë u mësuan të mos kryenin punën e tyre?

e. Bashkëpunimi i Serbisë në dialog në fillim doli të jetë i bazuar më shumë në regjimin autoritar sesa në atë demokratik.

ë. Edhe në qoftë se BE-ja dhe SHBA-ja do t'ia dilnin me sukses të menaxhonin të gjitha këto sfida, me Serbinë, që vazhdon të shënojë përparim të madh në integrimin drejt BE-së, Brukseli, Gjermania dhe aktorët e tjerë kyç duhej të gjenin një strategji të duhur komunikimi me politikëbërësit dhe qytetarët e Kosovës për të ndërtuar mirëbesim në procesin e dialogut dhe me qëllim që të siguroheshin ata se në fund do të prodhonte rezultatet e dëshiruara.

Kur kthejmë kokën prapa dhe shohim fatin e këtyre sfidave pas dy vjet e gjysmë të zba-

tim të ngadalshëm, mendja thotë se asnjë prej këtyre sfidave nuk është realizuar, derisa me disa prej tyre nuk është marrë askush deri më sot. Lideri i gjerman u dobësua për shkak të presionit të krizave të tjera të mëdha evropiane dhe botërore, dhe kështu ndodhi edhe me përkrahjen e Britanisë së Madhe pas ndryshimit të ministrit të Jashtëm dhe fiksimit britanik që të merret me fatin e ardhshëm të Britanisë në BE. SHBA-ja në dritën e dobësisë së BE-së është munduar të kërkojë veprime të njëanshme, që kanë mbetur pa efekt ose vetëm i kanë përkeqësuar gjërat.

Serbia është lejuar të përfshihet thellë në institucionet politike të Kosovës, derisa nuk është shënuar asnjë pikë përparimi për vënien e rendit dhe ligjit në veri, dhe me Listën Srspska, që po merr kontrollin e komunave me shumicë serbe në jug të lumit Ibër, dhe është shkatërruar përparimi i vogël, i arritur me shumë mund, në demokracinë lokale dhe vetëqeverisje. BE-ja ka humbur rastin që të ndërtojë mirëbesim në dialog, kështu që derisa Serbia ka hapur kapitujt e parë të anëtarësimit më 2015, qytetarët e Kosovës nuk e dinë se çfarë do të përfitojnë, nëse do të fitojnë diçka me nënshkrimin e MSA-së. Njëkohësisht, çështja për fundin e dialogut jo vetëm që ka mbetur pa përgjigje prej Perëndimit, por edhe është bërë e dukshme njëherësh se nuk ekziston ndonjë plan global. Asgjë nuk e ka demonstruar këtë boshllëk strategjik më qartë se dështimi në UNESCO. Në mungesë të një plani global dhe rezultateve të dukshme menjëherë për partitë në pushtet që t'ua shesin votuesve të tyre, Qeveria vazhdoi me kërkesën e njëanshme të aplikimit në UNESCO; si pasojë, mbështetja me gjysmë zemre e aleatëve kryesorë perëndimorë të Qeverisë së Kosovës përballë Serbisë dhe Rusisë, të cilat nuk kishin lënë

gur pa lëkundur në fushatën e tyre kundër, dështoi për shkak se nuk ia doli të fitonte mbështetjen e një grusht shtetesh që Kosova të shënonte një hap të madh drejt njohjes së plotë ndërkombëtare. Derisa lideri i gjerman i BE-së po dobësohej, ishte e natyrshme që burokracia e Brukselit që duhej ta mbulonte këtë boshllëk, në anën tjetër, me arsye të forta ka shtuar frikën në Kosovë se "përparimi" në dialog do të arrihej në kurriz të funksionalitetit të shtetit. Së fundi, në anën serbe Qeveria e Vuçiqit është zotuar për transformim proevropian të politikës së saj, por nuk ka zbatuar asnjë politikë që do ta ndryshonte pushtetin e tij autoritar - përkundrazi. Derisa Serbia ka shënuar përparim të theksuar në integrimin drejt BE-së prej vitit 2013, pjesa e politikës së Perëndimit për Serbinë për dialogun mbetet krejtësisht e paqëndrueshme.

Në kohën kur zbatimi i Marrëveshjes së prillit është ngadalësuar prej vitit 2013, Kosova nuk ka parë asnjë përparim në transformimin demokratik ose në zhvillimin ekonomik, dhe Perëndimi nuk është treguar i dobishëm në tregtimin e demokratizimit për dialogun. Dhe kur është përballur me pengesën e parë - përpjekjen e elitave politike të Kosovës për ta shndërruar Ligjin e amnistisë në amnisti të përgjithshme - BE-ja dhe SHBA-ja demonstuan prioritetin e tyre për të mbajtur dialogun gjallë në kurriz të tolerimit të shkeljeve të mëdha të parimeve themelore të sundimit të ligjit dhe të demokracisë parlamentare.

Andaj animi nga koalicioni i madh në nëntor të 2014-s pas dy vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Kushtetuese, paraqiste vazhdim logjik të kësaj qasjeje politike. Dhe përzjerja e SHBA-së dhe e BE-së nëpërmjet EULEX-it dhe Gjykatës Speciale u fashit me shtimin e sëmundjes strukturore të Kosovës me drejtësi selektive të llojit të vet. Është ironi fatkeqe që BE-ja dhe SHBA-ja në pazarin e tyre me demokracinë i kanë bërë dëm serioz edhe demokracisë edhe sundimit të ligjit në Kosovë, e edhe reputacionit të tyre tek qytetarët e Kosovës, por, megjithatë, nuk mundën të parandalonin vonesat e mëdha në zbatimin e Marrëveshjes së prillit, dhe madje edhe rrezikuan të ardhmen e dialogut me kontributin e tyre në krizën aktuale politike si tërësi.

Me qëllim që Perëndimi të ndreqë gabimet në politikën e vet ndaj Kosovës dhe të fitojë përsëri besimin e qytetarëve të vendit më 2016, BE-ja dhe SHBA-ja duhet të pranojnë se qasja e tanishme politike nuk është e qëndrueshme. Ato duhet të ringjallin dialogun me vizion strategjik. Ky vizion duhet të përfshijë përgjigje bindëse për të gjitha sfidat strukturore. Nëse Perëndimi nuk është i zoti t'ua japë përgjigje këtyre çështjeve, mund të jetë më e udhës që ta varrosë dialogun dhe të kërkojë qasje të re politike. Çfarëdo që do të jetë situata, BE-ja dhe SHBA-ja duhet menjëherë të heqin dorë prej kompromiseve në çështjet demokratike me liderët në Kosovë (dhe në Serbi). Dhe më e rëndësishmja, ato duhet të zhvillojnë një strategji parimore dhe të qëndrueshme të problemit të studimit të ligjit në Kosovë, në atë mënyrë që do të ndihmonte për kthimin e besimit të qytetarëve të Kosovës për Perëndimin, si dhe për institucionet e tyre politike.

(Autori është bashkëpunëtor i lartë i Këshillit për Politikë të Demokratizimit)

© KOHA Ditore



## Foto 2015

**Përleshja e armatosur e 9 majit 2015 në Kumanovë ka lënë pas vetes 22 të vrarë dhe shumë pyetje pa përgjigje për Maqedoninë, por edhe për gjithë rajonin. Prej të vrarëve, 14 ishin pjesëtarë të grupit të armatosur shqiptar, shumica prej Kosovës, ndërsa 8 ishin policë të Maqedonisë. Derisa rasti mbetet ende i pasqaruar dhe në Shkup tashmë ka nisur një proces kundër 29 shqiptarëve nën akuzën për terrorizëm. Situata politike, por edhe ndëretnike në Maqedoni, nuk duket se po qetësohet**

Foto: Driton Paçarada